



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORË
SENATI AKADEMIK

Nr. 1324/3 prot.

Vlorë, më 06 . 11 .2018

VENDIM

Nr. 69, datë 31.10.2018

PËR

**RIMIRATIM TË KRITEREVE TË PRANIMIT NË PROGRAMET E STUDIMIT TË
CIKLIT TË DYTË NË FAKULTETIN E SHKENCAVE HUMANE**

Mbështetur në nenet **76** dhe **38** të ligjit Nr. 80/2015 "Për Arsimin e Lartë dhe Kërkimin Shkencor në Institucionet e Arsimit të Lartë në Republikën e Shqipërisë", si dhe bazuar në shkresën e Dekanit të Fakultetit të Shkencave Humane, nr 232/3 prot., datë 31.10.2018 Senati Akademik në mbledhjen e datës 31.10.2018

VENDOSI:

1. Të miratojë kërkesën e Fakultetit të Shkencave Humane me nr. 232/3 prot., datë 31.10.2018 për rimiratim të kriterëve të pranimit në programet e studimit të ciklit të dytë: "Master i shkencave në edukim", "Master i shkencave në pedagogji të specializuar sociale", "Master i shkencave në mësimdhënie në gjuhë shqipe dhe letërsi", "Master i shkencave në përkthim-interpretim" në Fakultetin e Shkencave Humane, si më poshtë:

a) Në programin e ciklit të dytë të studimeve "Master i shkencave në edukim" do të pranohen kandidatët që:

- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë në disipinatat e mësimdhënies.
- Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë "Bachelor" ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në drejtimin disipinatar në mësimdhënie dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MAS-it.
- Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
- Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

b) Në programin e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave në pedagogji të specializuar sociale” do të pranohen kandidatët që:

- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë në pedagogjinë e specializuar, shkencat sociale, mjekësi, shëndet publik.
- Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në drejtimin disiplinor disiplinat pedagogjisë së specializuar dhe shkencat sociale dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR-së.
- Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
- Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

c) Në programin e ciklit të dytë të studimeve “Master i shkencave në mësimdhënie në gjuhë shqipe dhe letërsi” do të pranohen kandidatët që:

- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë “Bachelor në gjuhë shqipe dhe letërsi”.
- Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në drejtimin disiplinor gjuhë shqipe dhe letërsi dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR-së.
- Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare, deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
- Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.

d) Në programin e ciklit të dytë të studimeve “Master i Shkencave në përkthim-interpretim” do të pranohen kandidatët që:

- Kanë përfunduar me sukses studimet dhe janë pajisur me diplomën përkatëse të vlefshme në Republikën e Shqipërisë në një program të ciklit të parë “Bachelor” në gjuhë të huaj.
- Janë diplomuar jashtë vendit në një program studimi të ciklit të parë “Bachelor” ose në një program të integruar të studimeve të ciklit të dytë në gjuhë të huaj dhe kanë kryer njësimin e diplomës pranë MASR-it.
- Përcaktimi i kandidatëve fitues do të kryhet sipas rendit zbritës të notës së tyre mesatare deri në plotësimin e kuotave të shpallura.
- Parapëlqehen kandidatët që e kanë përfunduar ciklin e parë të studimeve pranë UV-së.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE
SENATI AKADEMIK

2. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohen Dekani i Fakultetit të Shkencave Humane, përgjegjësit e departamenteve pranë këtij fakulteti, komisionet e pranimit, sekretariatë mësimore të këtij fakulteti.
3. Vendimi i përcillet Ministrisë së Arsimit, Sportit dhe Rinisë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

NËNKRYETARI I SENATIT

Prof. As. Dr. Elenica Pjero

